

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

SH-32

Q 63

MIHALLAQ QILLERI

**ZBULIMI I ISHUVJE  
TË HUMBUR**

**novelë**




814-32  
263

MIHALLAQ QILLERI

# ZBULIMI I ISHUVJE TE HUMBUR

— novelë —



2122

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## I

Jashtë binte shi dhe bubullimat dëgjoheshin mbytur. Njëri nga kanatet e dritares nuk ishte mbyllur mirë dhe nëpërmjet tij era trokiste parvazin e jashtëm. Kishte rënë qetësi dhe ata pesëmbëdhjetë burra rrinin si mbi gjemba. Sapo kishte mbaruar ai debat, pas të cilit njëri prej tyre duhej të largohej qysh atë çast, edhe pse përjashta shfrynte stuhia. Nuk dihej kur mund të mbaronte ajo. Mund të heshte pas dy orësh, ashtu siç mund të vazhdonte katër ditë dhe net me radhë. Ishte fund dhjetori dhe stuhitë zbrisnin nga mali me një pararojë mjegulle të zezë, që zbrazte pikat e para të shiut. Malit i këputej koka nën këtë masë të errët, gjithë kërcënim, që grisej, mblidhej, nxinte dhe përpinte një gjelbërim të shpëlarë përrallesh. Këto kërcënime mbaronin me fillimin e dëborës. Fuqia e mjegullës ligshohej. Miliardat e pikave të ujit zbardheshin dhe i lejonin konturet të zbeheshin, të shfaqeshin dhe pastaj të zhdukeshin përsëri. Njëri nga ata të pesëmbëdhjetë duhej të largohej. Ky ishte mendimi i katër-pesë burrave, dhe të tjerët kishin heshtur. Mbi këtë njeri nuk ishte përqëndruar më asnjë vështrim. Tymi i cigareve mbështillte vështrimet, mendimet dhe stuhinë e vërtetë e fshihte nëpërmjet avullit që kishin zënë xhamat e dritares.

— Daleni! — thirri befaz dikush, që u ngrit nga krevati i poshtëm dhe qëndroi në këmbë. — Daleni! Jashtë

bie aq shumë shi, sa përroi duhet të ketë dalë i turbullt. Nuk ka ku të kalojë.

Këto pak fjalë ishin aq pa kuptim, sa të gjithë ngritën kokën dhe e vështruan të habitur. Atje, në cep të dhomës, pas tavolinës bojë qielli, Eva lëshoi stilolapsin mbi fletët e protokollit dhe i nguli sytë Fredit. A duhej t'i shkruante këto fjalë? Inxhinjeri ngriti pakëz nga tavolina pëllëmbën e shkurtër dhe e lëshoi përsëri pa zhurmë mbi fletët e bardha. Kjo do të thoshte se nuk duhej shkruar kjo shprehje. Ai i nguli sytë burrit që vazhdonte të rrinte në këmbë. E pa si shkëputi me nervozizëm bishtin e cigares nga buzët dhe e hodhi nën majën e opingës. Xhaketa i vinte e shkurtër dhe nën mëngët i dilnin ca duar të trasha pikaloshë, gjithë qime. Fytyra e tij me prenka, e gjatë dhe e thatë, kishte ngrirë një çast, dhe u duk se gjithë qetësia, habia, shtangia që ra edhe një herë pas fjalëve të tij, buronte nga ajo fytyrë e nemitur, që e shprehte preokupimin nëpërmjet rrudhave të sapoformuara në ballë.

— Daleni. . . — tha edhe një herë ai. — Hodua ka tre fëmijë. . . Kudo jetohej dhe. . . ai mund të jetojë. . . ashtu si të gjithë. Por, unë për vete, nuk e di. . . nuk jam i qetë. Ai ka tre fëmijë dhe më e madhja është një vajzë dymbëdhjetëvjeçe, shumë e zgjuar. . .

— Shënoi! — i pëshpëriti ngadalë Fredi vajzës, që vazhdonte ta vështronte e habitur. — Të gjitha. . . edhe ato të parat. . . Ashtu!

— Si mendon, a falet ky njeri? — pyeti dikush menjëherë, pasi vuri re që inxhinjeri diçka i pëshpëriti Evës.

— Nuk bëj fjalë për falje, — tha njeriu trupmadh. — Ka nevojë për vëmendje. Unë nuk e di. . . Ai nuk është gur, që mund ta vërvitim ku të duam.

— Po ai nuk pranon asgjë, mor shokë! — u hodh befas një djalë, që nuk i kalonte të njëzetepesat. — Ç'jemi

ne që mblidhemi e diskutojmë për të? Ai nuk na përfill fare... dëgjoni?... fare! Ne nisemi për në një vend të largët dhe na kanë dhënë një detyrë... Me këtë njeri nuk mund të bëjmë asgjë. Na e ka sjellë shpirtin në majë të hundës! As plan shteti dhe as para për vete. Unë e kam nga fshati... E njoh mirë, por përsëri nuk mund të fal një njeri të pandreqshëm. Se mos është e para herë që po na e bën këtë! Ti, inxhinjer Fredi, më duket se e ke përkrahur më tepër se ç'duhej. Dëgjon, inxhinjer?!

— Dëgjoj... — tha inxhinjeri me zë fare të ulët. — Ashtu është... e kam përkrahur. Ti ke të drejtë... Dhe unë them ta përkrah përsëri. Kam po atë mendim. Ky njeri nuk duhet të largohet nga ne. Mendoj se ne kemi aq forca... Ose, djalli ta marrë! — ai e ngriti zërin me një gjest të qartë zemërimi, — atëherë, për dëmin që na ka sjellë t'ia japim gjyqit. Rrugë të mesme nuk ka!

Stuhia u platit një çast. Pikat e rralla trokisnin mbi llamarinat e çatisë së barrakës. Dalëngadalë po binte mbrëmja. Një mbrëmje e shpejtë, që sillte natën e gjatë të dhjetorit. Natën mund të binte dëborë dhe mali të ndiqte bi-shat. Qentë do të lehnin gjithë natën, dhe në nomë tufat e bagëtive do të strukeshin më pranë njëra-tjetrës.

Hodoja rrinte në njërën nga karriget, pas krevatit, dhe tavolinën ku ishin ulur inxhinjeri dhe vajza e re e shikonte nëpërmjet hapësirës që krijohej ndërmjet shtratit të poshtëm e të sipërm. Në sytë e tij kishte një shprehje të përcaktuar. Ai e ndiente se duhej të fliste, jo më tepër për t'u mbrojtur, sesa të thoshte se gjyqi që sapo i kishin përmendur, ishte hapur para disa orësh, me të vetmin ndryshim se debatet e gjyqtarëve për të dhënë vendimin, zhvilloheshin para syve të tij. Por truri i ishte mpirë dhe në majë të gjuhës i zbriste vetëm një fjalë: Pleh! Ta thoshte këtë, kishte frikë se mos nuk e kuptonin. Pas kësaj ai nuk do të dinte të jepte shpjegime, dhe inxhinjeri mund të

fyej i pari. Uli kokën. Lëvizi karrigen nga vendi dhe kërkoi nëpër xhepa paketën e cigareve. Në tridhjetë e pesë vjeç, ndofta për herë të parë, hapej në shpirtin e tij, një vend, diku në thellësi të vetvetes, ku zinin vend fjalët më të rënda se plumbat. Jo, nuk duhej të fliste! Pas kësaj mbledhja do të mbaronte...

— Unë kam një mendim tjetër, — tha burri trupmadh. — Jam minator prej më se dhjetë vjetësh, por, siç e dini, nuk kam lindur i tillë. Hodua le të vijë të punojë me mua. Ndofta do t'ia dijë më shumë vlerën punës. Është mekanik? Le të jetë edhe inxhinjer! Ne ia kemi mësuar zanatin, ne edhe mund t'ia heqim. Kaq kisha... Ti, bijë e xhaxhait, shënoi këto të gjitha. Thuaj aty se Hodua është shoku im, dhe unë nuk e lë të rrëzohet. Ai ka një vajzë të zgjuar që nesër mund të bëhet gjeologë... si ti. Nuk dua të ketë turp për babanë e saj. Kaq kisha!

Përsëri ra një heshtje e gjatë. Hodoja shtypi majën e cigares. Pastaj vështroi minatorët. Errësira kishte rënë aq befasisht, sa dhoma u zhyt në gri. Djali i ri hapi përgjysmë derën e dhomës. Ndezën dritën. Debatet e zjarra sikur i përpiu dita. Nata sillte një logjikë më të mprehtë. Shiu nisi përsëri, në fillim me tërbim, pastaj shtruar. Monotonia e zhurmës së pikave mbi llamarinat e çatisë shtonte vëmendjen. Inxhinjeri diçka shënoi mbi një fletë të bardhë që mbante përpara dhe u ngrit në këmbë.

— E dëgjuat, besoj. Ka edhe një propozim të fundit. Pandua mendon se Hodua duhet të punojë në galeri si ndihmësminator. Kush është dakord?

Ai ngriti dorën i pari dhe vuri re se në fillim askush nuk reagoi nga fjalët e tij. Eva la përsëri stilolapsin dhe ngriti edhe ajo dorën. Pastaj u ngritën dhjetë duar të tjera. Vetë Pandoja nuk ngriti as kokën. Në protokoll u shënuan votat. Hodoja lëvizi në karrige. Jo, nuk duhej të fliste. E, ç'të thoshte?

Minatori u ngrit befas dhe çau në mes të karrigeve. Iu afrua Hodos dhe i ngriti kokën.

— Të pëlqej unë, mor djalë?

— Po, — tha Hodoja.

— Jam dhjetë vjet më i madh se ti. Kam gjashtë fëmijë dhe deri më sot nuk i kam turpëruar. As që do t'i turpëroj!

— Edhe unë, — tha Hodoja.

— Mirë. Çohu tani dhe shko të flesh. Nesër do të nisemi.

— Do të vete në punë, — tha Hodoja.

— Ka kush e bënë punën tënde për sot... Apo jo, inxhinjer? Mos fola para teje? S'prish punë! Unë kështu mendoj. Natën e mirë!

U ngritën të gjithë. Mblodhën karriget portative. Hodoja doli i pari. Jashtë, nata e lagësht kishte pushtuar hapësirën. Tej, në thellësi të errësirës, dalloheshin ca drita të rralla. Fshati ishte ndonja dy kilometra larg dhe aty ku ishte ngritur qendra e këtij ekipi të vogël gjeologjik, shkonte një rrugë e verbër, që lidhej me rrugën automobilistike tej në Qafën e Luadhit. Malin e kishte pas shpine.

Dhoma e inxhinjerit, që shërbente edhe si zyrë, ishte në mes të barrakës. Ai i mori vajzës protokollin, e kyçi në kasafortën metalike dhe veshi çizmet.

— Eja, — i tha asaj. — Do të të përcjell unë sonte!

Ajo mbështolli shallin pas qafës, ngriti jakën e peliçes dhe futi duart në xhepa. Nën çadër shiu dëgjohej me kërcënim dhe ajo u afrua më shumë pranë tij. Zbritën rrugën e makinës. Nata ishte aq e errët, sa nuk shikoje dot as dy hapa më tej. Ujërat kishin nisur të hapnin dy brazda të thella në mes të rrugës, nga rridhnin përrenj të vërtetë. Ecën një kohë të gjatë pa folur. Ai e ndiente se çështja e Hodos e kishte lodhur aq shumë atë mbrëmje, sa nuk kishte asnjë dëshirë të shfaqte ndonjë shqetësim tje-

tër. Urdhëri nga drejtoria kishte ardhur vetëm tri ditë më parë dhe i kishte gjetur të gjithë të papregatitur. Aq më pak Evën. Vajza kishte vetëm katër muaj që kishte nisur punën në ekipin gjeologjik, afër fshatit të saj, sapo kishte mbaruar teknikumin. Në shtëpi ishin gëzuar shumë që puna e saj u gjend aq afër, dhe të gjitha shqetësimet ishin platurt. Tani urdhëri i ri i ndryshonte të gjitha. Babai i Evës, këtë Fredi e dinte mirë, ishte gati ta dërgonte vajzën edhe në zonën më të largët, kurse me t'ëmën ndryshonte puna. . .

— Po ti, — e pyeti ai befasisht, — në mbledhje m'u duke aq e heshtur, sa nuk dhe asnjë mendim.

— Unë jam akoma e re këtu — u përgjigj ajo.

— Jo, — e kundërshtoi. — Aspak. Çështja ishte aq e qartë, sa nuk kishte nevojë për vjetërsi në punë.

— Asgjë nuk mund të shtojë pas fjalëve të Pandos, — tha ajo.

— Mundet, — tha Fredi. — Ishte e vetmja rrugë e drejtë. . .

— E ke përkrahur ti?

— Po, — pëshpëriti ai.

— Pse?

— Një lloj keqardhjeje mikroborgjeze. . . Ose mund të më ketë shtyrë diçka tjetër. . . Nuk e di. . . Nuk ndiej asnjë lloj armiqësie ndaj atij njeriu. Megjithatë na ka sjellë kaq shumë shqetësime.

— Në tridhjetë e pesë vjeç njeriu duhet të jetë pjekur plotësisht, — tha Eva.

— Ai njeri ka nevojë të mësojë dhe të lexojë shumë. E di ti, Eva, ç'të kaluar ka pasur Hodua?

— Jo, — tha ajo. — Pse?

— Një herë tjetër do të ta tregoj. Ndoshta kur të vemi në Gravicë. Ai atje do të jetë i lidhur më tepër me punën dhe me njerëzit. E kam këtë besim.

— Mundet, — tha ajo.



U dukën dritat e shtëpisë. Përroi zhurmonte poshtë rrepeve të zhveshura. Ajo hapi deriçkën e gardhit, la të kalonte më parë Fredi dhe u nis pas tij. Qeni lehu dy-tri herë pastaj erdhi pas saj dhe iu fërkua pas këmbëve.

Para derës së shtëpisë ai mbajti këmbët.

— Merr rroba të trasha me vete, — tha ai. — Gravica është një mijë metra mbi nivelin e detit, ndërsa punimet janë ku e ku më lart.

— Të marr edhe ndonjë libër me vete?

— Merr. Unë për vete lexoj shumë. Merr... Para se të të zërë gjumi, mund të lexosh diçka...

— Natën e mirë!

— Mos e acaro punën me mamanë. Kuptoje drejt dhe mundohu t'i mbushësh mendjen. Natën e mirë!

— Fredi... po ti nuk do të vesh fare në shtëpi?

— Jo, më vonë. Do të paraqitem njëherë atje, pastaj shohim e bëjmë.

Ata flisnin me zë të ulët. Shi binte më pak dhe nëpërmjet dritës së ballkonit mund të dalloje mjegullën e bardhë, që ngatërrohej nëpër degët e zhveshura të pemëve. Qeni vërtitej midis këmbëve të tyre, shkundte lagështinë e tepërt nga trupi dhe lëpinte herë pas herë dorën e vajzës. Nga brenda shtëpisë dëgjohej spikeri i Radio Tiranës tek jepte emisionin e lajmeve të orës shtatë.

— Epo... — tha ajo. — gjumin e ëmbël!

Ai tundi vetëm kokën në vend të përshëndetjes, përkëdheli kurrizin e lagur të qenit, sikur t'i uronte edhe atij natën e mirë dhe u kthye të ikte.

Në barrakë kishte rënë qetësia. Megjithëse të nesërmen do të niseshin për një rrugë të largët, minatorët kishin vendosur të punonin edhe atë natë. Galeria 23 ishte në metrin e fundit. Minerali ishte kapur, por Fredi kishte porositur të avancohej edhe nja dy metra. Dhoma e tij ishte fare e vogël. Gjithë gjithë aty kishte një krevat, tavo-

linën e punës, kasafortën, një raft, mbushur me kampione dhe dy karrige portative. Në mur varej harta e madhe gjeologjike e Shqipërisë. Eva, para dy muajsh, ishte kujdesur të sillte nga shtëpia dy degë lulevarëse, të cilat ishin zhvilluar shumë. Ato i jepnin dhomës me të vërtetë ngrohtësi, dhe ai e ndiqte me shumë dashuri rrijten e shpejt të kërcellit të lules.

U zhvesh dhe u shtri në krevat. Ndezi transistorin, por u pendua dhe e fiku përsëri. Flinte gjithmonë me dy jastëkë, por atë natë e ndjeu se kokën e kishte të rëndë dhe mendoi se fajin e kishte jastëku i dytë. E hoqi mënjane dhe u mbështoll më mirë me batanije. Shiu kishte pshuar, por kishte nisur të frynte një erë e fortë. U vërvit për një kohë të gjatë sa në njërin krah në tjetrin. Gjumi nuk po i vinte. Ishte akoma herët. Ora nuk kishte kaluar as nga teta. Në një mbrëmje tjetër ai do të kishte lexuar, ose do të kishte bërë muhabet me minatorët. Kishte raste kur shkonte në fshat dhe atje e kalonte mbasditën në dhomën e arsimitarëve. Por atë natë nuk kishte me kë të këmbente asnjë fjalë. Dy-tre nga punëtorët ishin vendas dhe kishin shkuar të kalonin natën e fundit në shtëpitë e tyre. Të tjerët kishin shkuar në punë. Hodoja s'dihej ku ishte. Ai e kishte shtëpinë tri-katër orë larg ekipit gjeologjik dhe më të shumtat e netve gdhijej aty.

— Ndoshta ka ikur në shtëpi, — mendoi Fredi. Megjithatë, iu duk një ndërmarrje e rrezikshme ai udhëtim prej tri-katër orësh, në atë kohë aq të keqe. Këtë Hodoja nuk e kishte bërë kurrë.

Ndiente një farë keqardhjeje të çuditshme që ishte i detyruar të largohej nga ai vend. Aty kishte pesë vjet që punonte dhe në të gjithë zonën ishte bërë si njeri i shtëpisë. Puna e kishte lidhur me aq shumë njerëz, sa njihte jo vetëm të rriturit e fshatit, por edhe fëmijët e vegjël. E dinte se do të kthehej përsëri. Tani shkonte në një ekspe-